



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Shqiptim i Vendimit mbi Referimin e z. Mahir Hasani  
në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018**

**(KSC-CC-2019-05)**

20 shkurt 2019

Në Hagë, Holandë

**Hyrje**

Ky shqiptim është një përmbledhje e vendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Dhoma”) mbi Referimin që z. Mahir Hasani (“Parashtruesi”) i ka paraqitur Dhomës më 15 janar 2019 (“Referimi”), në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”). Parashtruesi përfaqësohej nga dr. Artan Qerkini.

Pas njoftimit të Dhomës për Administratoren më 13 shkurt 2019 në lidhje me datën e shqiptimit, publiku u informua paraprakisht për datën dhe orën e tij. Teksti i këtij shqiptimi gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në tri gjuhët zyrtare të këtij institucioni.

**Historik i shkurtër procedural**

Në Referimin e tij të datës 15 janar 2019, Parashtruesi bën ankesë se Urdhri i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“Urdhri”) që e urdhëron atë, si person i dyshuar, të paraqesë dokumente dhe informacione të caktuara, cenon të drejtën e tij për të heshtur dhe është në kundërshtim me privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes sipas nenit 30(6) të Kushtetutës. Ai gjithashtu pretendon se Urdhri cenon të drejtën e tij për

t'u prezumuar i pafajshëm sipas nenit 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

Parashtruesi bëri kërkesë në bazë të rregullës 21(1) dhe (2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e Punës"), për një masë të përkohshme për pezullimin e Urdhrit deri në marrjen e vendimit nga Dhoma në lidhje me Referimin.

Më 15 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), caktoi një panel të Dhomës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me Referimin.

Më 18 janar 2019, Dhoma e lejoi Prokurorin e Specializuar të paraqiste parashtrimin e tij në përgjigje të kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme. Prokurori i Specializuar e paraqiti parashtrimin e tij më 25 janar 2019.

Më 7 shkurt 2019, Dhoma e pezulloi Urdhrin duke qenë se e *detyronte* Parashtruesin të paraqesë dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuar në të. Dhoma konfirmoi se pezullimi i Urdhrit nuk paragjykonte vendimin e saj në lidhje me Referimin. Gjithashtu, Dhoma konfirmoi se pezullimi i Urdhrit nuk paragjykonte detyrimin e Parashtruesit për t'u paraqitur për marrje në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 11 shkurt 2019.

Më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një Njoftim për Tërheqje të Urdhrit dhe Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit.

Pas shpalljes së vendimit në lidhje me kërkesën e Parashtruesit për masë të përkohshme, ky shqiptim përmbledh vendimin e Dhomës në lidhje me aspektin material të Referimit. Gjithashtu në të jepet edhe përgjigja e Dhomës ndaj Kërkesës së Prokurorit të Specializuar për hedhjen poshtë të tij.

Paneli Kushtetues i përbërë nga gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare, dhe gjykatësit Vidar Stensland dhe Roland Dekers, pas kuvendimeve kokë më kokë dhe në largësi përmes mjeteve elektronike, nxori konstatimet e tij mbi Referimin.

### **Historik i shkurtër i fakteve**

Më 20 dhjetor 2018, Zyra e Prokurorit të Specializuar i dorëzoi Parashtruesit dy dokumente, përkatësisht një fletëthirrje për t'u paraqitur për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019 ("Fletëthirrja") dhe Urdhrin për t'i dorëzuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar dokumente dhe informacione të caktuara në të njëjtën ditë.

Në Urdhër thuhej se Parashtruesi ishte "i detyruar të paraqiste" dokumente dhe informacione të caktuara të specifikuar në të. Urdhri gjithashtu paralajmëronte se mosparaqitja e dokumenteve do të konsiderohej "mosbindje" dhe si rezultat i kësaj Zyra e Prokurorit të Specializuar mund të kërkonte marrjen e masave që detyronin bindjen ndaj Urdhrit.

Urdhri gjithashtu konfirmonte se ekzistonin arsye për të besuar që Parashtruesi ishte përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

### **Juridiksioni**

Në Referimin e paraqitur në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, Parashtruesi bën ankesë në lidhje me Urdhrin e lëshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Pra, Referimi *ka të bëjë* me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, siç e kërkon neni 162(3) i Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim mbi Referimin.

## **Konstatimet**

### *Reflektime paraprake mbi Ligjin*

Në fillim, Dhoma rikujton detyrën e vet për mbikëqyrjen e punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar lidhur me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

Për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, neni 22(2) i saj parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës. Gjithashtu, sipas nenit 53, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë duhen interpretuar në një mënyrë që është në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Bazuar në sa më sipër, gjatë shqyrtimit të këtij Referimi Dhoma ka mbajtur parasysh në veçanti jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut.

### *Shkeljet e pretenduara*

Referimi i Parashtruesit ka të bëjë me të drejtën për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes, sikurse garantohen në nenin 30(6) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Referimi ngre pyetjen nëse ato garanci janë të zbatueshme edhe për fazën hetimore të procedurës penale dhe në veçanti, për rrethanat në të cilat autoritetet e urdhërojnë një të dyshuar të konfirmuar që të paraqesë dokumente dhe informacione gjatë hetimit penal.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar se garancitë që ofron neni 6(1) dhe (3) i Konventës janë të zbatueshme për një person që është objekt i një “akuze penale”. Neni 30 i Kushtetutës gjithashtu parashikon të drejtat minimale të një personi “të akuzuar për veprë penale”. Gjykata e Strasburgut përdor qasjen materiale përkundër asaj formale për t’i dhënë përgjigje pyetjes se kur një person mund të konsiderohet objekt i një akuze penale. Në vitin 2016, në *Ibrahim and Others v. the United Kingdom*, Dhoma e Madhe e Gjykatës së Strasburgut miratoi qasjen e përdorur

më herët në *Aleksandr Zaichenko v. Russia*, ku Gjykata kishte shpjeguar se nëse ekziston dyshimi që një person ka kryer vepër penale, ai person konsiderohet se është objekt i një 'akuze' në kuptimin e nenit 6 të Konventës.

Mbi këtë bazë, Dhoma vëren se Urdhri i lëshuar konfirmonte që ndaj Parashtruesit ekzistonte një dyshim. Duke pasur parasysh këtë konfirmim, Dhoma mendon se në rastin e Parashtruesit vepronin dhe ishin të zbatueshëm neni 30 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës, në veçanti e drejta për të heshtur dhe privilegji për të mos inkriminuar vetveten.

Dhoma rikujton se qëllimi i së drejtës për të heshtur dhe i privilegjit të mosinkriminimit të vetvetes është që të mbrojë personin e akuzuar nga detyrimi i palejueshëm prej autoriteteve dhe rrjedhimisht të shmangë mohimin e drejtësisë. Është ekzistenca e detyrimit ajo që ngre çështjen nëse është respektuar privilegji i mosinkriminimit të vetvetes.

Dhoma është bindur se sipas kushteve të urdhrit të lëshuar, ekzistonte një element i qartë detyrimi. Ai përbëhej nga një *paralajmërim* se nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet e specifikuar, kjo mosparaqitje do të konsiderohej 'mosbindje'. Kërcënimi se do të nisej procedim ligjor për të detyruar zbatimin nëse Parashtruesi nuk do t'i paraqiste dokumentet e forconte edhe më tej elementin e detyrimit. Dhoma e mendon të përshtatshme të rikujtojë dy aspekte në juridiksionin e Gjykatës së Strasburgut që lidhen me pasojat e një detyrimi të tillë.

**Aspekti i parë** lidhet me përdorimin e mëvonshëm në gjykim të informacionit të përfutur nën kërcënim. Ai ka të bëjë me raste si ai i *Saunders v. the United Kingdom*, ku një i dyshuar jep dëshmi si rezultat i kërcënimit për marrje masash ndëshkimore dhe dëshmia përdoret më vonë në gjykimin e atij personi. Në rastin tonë, Parashtruesi argumentoi se në rast se do të ketë gjykim kundër tij, dokumentet dhe të dhënat që ai ishte urdhëruar të paraqiste nën kërcënimin e masës ndëshkimore, më vonë mund ta

dëmtonin mbrojtjen e tij dhe t'i jepnin një avantazh të pandershëm Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Dhoma vëren se, ndryshe nga *Saunders v. the United Kingdom*, në rastin e Parashtruesit nuk është zhvilluar gjykim dhe as nuk ka pasur vendim fajësie. Dhoma nuk mund të hamendësojë nëse Parashtruesi do të përballej me gjykim, nëse do të ishin përdorur dokumentet e specifikuar në Urdhër, nëse Parashtruesi do të ishte shpallur fajtor dhe nëse, si pasojë, do të ishte kompromentuar drejtësia e gjykimit në tërësi, nëse do të ishte zhvilluar një i tillë. Nëse Urdhri nuk do të ishte tërhequr, Dhoma është e bindur se ky aspekt i ankesës së Parashtruesit, pra që detyrimi për të paraqitur dokumentet e specifikuar do të kishte ndikuar në drejtësinë e gjykimit, ishte i parakohshëm.

**Aspekti i dytë** në jurisprudencën e Strasburgut lidhet me masat ndëshkimore që jepen kundër një të dyshuari në qoftë se refuzon të paraqesë informacione të caktuara. Ky problem del në raste si ai i *Heaney dhe McGuinness v. Ireland*, ku të dyshuarit i kërkohet të paraqesë informacion nën kërcënimin e masës ndëshkimore dhe në vijim ndëshkohet nëse refuzon ta bëjë këtë. Dhoma është e bindur që, në një situatë të tillë, përsëri mund të veprojnë neni 6 i Konventës edhe në qoftë se ndaj individit nuk ngrihet aktakuzë në bazë të procedurës fillestare, ose në qoftë se shpallet i pafajshëm pas gjykimit, nëse do të ketë një të tillë.

Sipas argumentimit të Parashtruesit, Urdhri përbënte një detyrim të palejueshëm për t'i dhënë Zyrës së Prokurorit të Specializuar prova potenciale, sepse përmbante paralajmërimin se mosparaqitja e dokumenteve nga Parashtruesi do të konsiderohej mosbindje, si edhe kërcënimin se si rezultat i kësaj mund të merreshin masa për të siguruar bindjen ndaj Urdhrit. Duke pasur parasysh këto kushte të Urdhrit të lëshuar, Dhoma rikujton se në *Heaney dhe McGuinness v. Ireland* Gjykata e Strasburgut konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës në rrethanat kur, gjatë kryerjes së një hetimi penal, parashtruesve që ishin të dyshuar u ishte kërkuar nën kërcënimin e masave ndëshkimore t'u jepnin punonjësve të policisë informacione të caktuara. Të dyshuarit

kishin refuzuar ta bënë një gjë të tillë dhe në vijim autoritetet i kishin ndjekur ata penalisht për mosdhënien e informacionit.

Duke u bazuar në atë jurisprudencë, për Dhomën është e qartë natyra e palejueshme e Urdhrit të lëshuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Nëse kundër Parashtruesit do të kishte një konstatim mosbindjeje për shkak të ushtrimit të të drejtave të tij kushtetuese dhe nëse ndaj tij do të ishin marrë masa detyruese sepse e kishte bërë këtë, atëherë sipas të gjitha gjasave kjo do të kishte çuar në një situatë të palejueshme sipas nenit 30(6) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

Për ruajtjen e të drejtave kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten, më 7 shkurt 2019 Dhoma e pezulloi Urdhrin e lëshuar, duke qenë se e *detyronte* Parashtruesin të paraqiste dokumentet dhe informacionet e specifikuar në të. Masa e përkohshme siguroi ruajtjen e statukuosë deri në marrjen e vendimit për Referimin. Ajo siguroi gjithashtu që ndaj Parashtruesit nuk mund të bëhej konstatim për mosbindje dhe nuk mund të merreshin masa detyruese në qoftë se do të kishte zgjedhur të ushtronte të drejtën e tij për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten kur të paraqitej për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019.

Pasi e shqyrtoi rastin e Parashtruesit, Dhoma është bindur se, siç paraqitet situata tani, ndaj Parashtruesit nuk ekziston asnjë konstatim për mosbindje dhe as nuk janë marrë masa detyruese për mosparaqitjen e dokumenteve të specifikuar në Urdhrin e lëshuar. Në qoftë se do të ishin nisur procedura të tilla, atëherë mund të ishte ngritur çështja lidhur me të drejtën për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit edhe sikur statusi i Parashtruesit të mos ndryshonte nga i dyshuar në të akuzuar.

### **Zhvillime të mëvonshme**

Dhoma vëren se më 15 shkurt 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi një Njoftim për Tërheqje të Urdhrit që është objekt i këtij Referimi, si dhe një Kërkesë për Hedhjen Poshtë të Referimit në fjalë.

Në mbështetje të Kërkesës së tij Prokurori i Specializuar argumentonte se duke e tërhequr Urdhrin, rrethanat për të cilat bën ankesë Parashtruesi pushojnë së ekzistuari. Ai argumentonte më tej se çdo pasojë e mundshme e ndonjë shkeljeje të pretenduar të të drejtave të Parashtruesit tashmë është ndrequr, së pari përmes masës së përkohshme të urdhëruar nga kjo Dhomë dhe së dyti, si rezultat i tërheqjes së Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar.

Në lidhje me këtë, Dhoma rikujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar se, në parim, një vendim ose masë në favor të një parashtruesi nuk është e mjaftueshme për t'i hequr atij statusin e viktimës, përveç nëse autoritetet shtetërore e kanë pranuar, qoftë shprehimisht apo në thelb, dhe kanë ndërmarrë në vijim masa ndreqëse në lidhje me shkeljen e Konventës.

Megjithatë, Dhoma është e mendimit se në këtë fazë të hershme të procedurës nuk kërkohet të merret në shqyrtim mjaftueshmëria e pranimit apo e masës ndreqëse, veçanërisht në rrethanat kur Referimi i Parashtruesit nuk ishte deklaruar i pranueshëm përpara tërheqjes së Urdhrit.

Dhoma është e mendimit se në përcaktimin nëse një çështje duhet të hidhet poshtë, ajo mund të marrë parasysh ngjarjet që ndodhin pas dorëzimit të Referimit. Për Dhomën, çështja nëse Parashtruesi mund të pretendojë ende se është viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese në thelb do të thotë se duhet të merren parasysh realitetet e situatës së tij. Kjo do të thotë gjithashtu se zhvillimet e ndodhura që prej dorëzimit të Referimit duhet të shqyrtohen patjetër.

Në shqyrtimin e të gjitha rrethanave të rastit të Parashtruesit, Dhoma vëren se ai i ka kërkuar kësaj Dhome ta anulojë Urdhrin e lëshuar, ose në alternativë *'të urdhërojë Zyrën e Prokurorit të Specializuar të anulojnë të njëjtin Urdhër'*. Dhoma është bindur se me dorëzimin e Njoftimit për Tërheqje të Urdhrit, Prokurori i Specializuar në fakt dhe me vullnetin e tij, e ka tërhequr Urdhrin. Kjo masë e ka kthyer faktikisht Parashtruesin në gjendjen që ishte para se të lëshohej Urdhri.



Në këto rrethana, Dhoma nxjerr përfundimin se për Parashtruesin nuk ekziston më arsye objektive për të proceduar më tej me Referimin.

Dhoma është bindur se me tërheqjen e Urdhrit, rrethanat e kundërshtuara nga Parashtruesi nuk qëndrojnë më. Po kështu, Dhoma është bindur se janë shmangur pasojat e ndonjë shkeljeje të mundshme të të drejtave kushtetuese të Parashtruesit si pasojë e Urdhrit të lëshuar.

Rrjedhimisht, Parashtruesi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të tij kushtetuese.

### **Përfundime**

Dhoma është e mendimit se në situatën e Parashtruesit *hynin në veprim* e drejta për të heshtur dhe privilegji i mosinkriminimit të vetvetes në bazë të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, sipas kushteve të Urdhrit të lëshuar. Në pamje të parë Urdhri ishte problematik duke qenë se *e detyronte* Parashtruesin, një i dyshuar i konfirmuar, që të paraqiste dokumentet dhe informacionet dhe e paralajmëronte atë për konstatim *mosbindjeje* dhe për masa të mundshme detyruese në rast se nuk do t'i paraqiste dokumentet.

Në përputhje me nenin 49(1) dhe (3) të Ligjit, detyra e kësaj Dhome është të vlerësojë nëse rrethanat për të cilat ankohet Parashtruesi cenonin të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara në Kushtetutë. Nuk është roli i kësaj Dhome të trajtojë gabimet e pretenduara të bëra gjatë procedurës penale, përveç dhe vetëm nëse këto gabime mund të kenë të bëjnë me një shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë. Ankesat në rastin në fjalë ngritën çështje të rëndësishme në lidhje me shkelje të pretenduara të të drejtave të Parashtruesit sipas Kushtetutës për shkak të Urdhrit të lëshuar.

Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se të drejtat kushtetuese të Parashtruesit për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten u ruajtën përmes masës së përkohshme kur ai u paraqit për t'u marrë në pyetje më 11 shkurt 2019, si dhe duke pasur parasysh që Prokurori i Specializuar në vijim e tërhoqi Urdhrin e lëshuar, Dhoma është bindur se Parashtruesi nuk mund të pretendojë më se është viktimë e shkeljeve të pretenduara sipas nenit 30(6) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.

Ky konstatim qëndron gjithashtu edhe në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës, sipas së cilës Parashtruesi ankohej se Urdhri i lëshuar cenonte prezumimin e pafajësisë duke e bartur barrën e provës te ai.

Duke qenë se Urdhri që përbën bazën e ankesës së Parashtruesit është tërhequr, Referimi duhet të deklarohet i papranueshëm në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së Punës.

Po kështu, në bazë të rregullës 21(6) të Rregullores së Punës dhe duke mbajtur parasysh tërheqjen e Urdhrit nga ana e Prokurorit të Specializuar, masa e përkohshme e urdhëruar më 7 shkurt 2019 pushon së vepruari menjëherë.

### **Data e hyrjes në fuqi**

Ky Vendim mbi Referimin hyn në fuqi menjëherë.

### **Vendim**

Pas dhënies së kësaj përmbledhjeje të vendimit të Dhomës, dispozitat operative të Vendimit të saj janë si vijon:

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

*E deklaron* të papranueshëm Referimin në lidhje me Urdhrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 20 dhjetor 2018.

Këtu përfundon shqiptimi i vendimit të Dhomës.

**Gjykatëse An Pauër-Ford**  
**Kryetare e Dhomës**